



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
DREJTORIA E PROKURIMEVE PUBLIKE

Elbasan, më . . .2023

Procesverbal -Tipi i kontrates - Mall

(Për argumentimin e kriterëve të përgjithshme dhe të veçanta të kualifikimit)

OBJEKTI I PROCEDURËS -“Blerje pajisje mobilerie për shkollat “Konstandin Kristoforidhi”, shkollën “Onufri” dhe shkollën “Hamit Mullisi”

LLOJI PROCEDURËS - “Procedurë e hapur – mallra”- Marreveshje Kuader

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): Kodi CPV: Mobilje dhe pajisje të ndryshme-39150000-8

VLERA TOTALE E FONDIT LIMIT - 12’367’174 (dymbëdhjetë milion e treqind e gjashtëdhjetë e shtatë mijë e njëqind e shtatëdhjetë e katër) **lekë pa t.v.sh.**

I mbajtur sot me date **.09.2023**, në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti kontrator Bashkia Elbasan ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

Shtojca 7

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PRANIMIT/KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë veprë penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;

ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortaku, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendimi i gjykatës i formës së prerë për çdo veprë penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;

d) nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë në lidhje me veprimtarinë profesionale;

dh) nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;

e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.

f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;

g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;

gj) ka paraqitur një Ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;

h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.

i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentet e gjuhës së huaj duhet të shoqërohen nga një përkthim i noterizuar në shqip.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 8.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet/Entet Kontraktore.

Në çdo rast, Autoriteti/EntiKontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.
- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit ose entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

Kriteret e përgjithshme përmbajne listën e dokumentacionit, ligjor dhe administrativ, të kandidatëve/ofertuesve, që duhet të plotësojnë për të marrë pjesë në procesin e prokurimit, në përputhje me nenin 76 dhe 77 të LPP-së, nr.162 date 23.12.2020 “Per prokurimin Publik”.

Kriteret e përgjithshme për pranimin e operatorëve pjesëmarrës janë të pandryshueshme dhe janë vënë të njëjta me Dokumentet Standarde të Tenderit sipas Vendimit Nr. 02 Datë 09.06.2021 të miratuara nga APP.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. *Formularin e Ofertes, sipas shtojces 1;*
- b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*
- c. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8;*

Kriteret (a-c) janë vendosur në përputhje me Dokumentat e Tenderit të miratuara nga APP bazuar në Vendimit Nr. 02 Datë 09.06.2021 si dhe bazuar në Ligjin Nr.162/2020 “Per prokurimin publik”.

Pika b) është vendosur në bazë të nenit 30 pika 1 të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

2.1. Kapaciteti ligjor i operatorëve ekonomikë:

Sipas Shtojcës 7.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Operatori ekonomik duhet të paraqese kopje te deklaratave te xhiros vjetore te leshuara nga administrate tatimore pergjate tre viteve te fundit, ku vlera e xhiros per te pakten nje nga vitet e periudhes se kerkuar duhet te jete **jo me e vogel se vlera e fondit limit** te prokuruar.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Vendosija e këtij kriteri kualifikues i shërben Autoritetit Kontraktor për të vërtetuar se operatori ekonomik fitues i zoteron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontratën.

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiar 2020, 2021, 2022, të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve në përputhje me Ligjin nr.10091, datë 05.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabel të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar", i ndryshuar, Kreu V, neni 41, pika c. Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Kriteri 2.2.2 është vendosur referuar nenin 43, pika 4 të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe bazuar në Nenin 77 pika 3, e LPP nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe Ligjin nr.10091, datë 05.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabel të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar", i ndryshuar, Kreu V, neni 41, pika c.

2.2.3 Operatori ekonomik duhet të paraqese një vërtetim që ka paguar **taksat dhe tarifat vendore për vitin 2023 (këstet e maturuara)** për çdo vend të ushtrimit të aktivitetit (sipas QKB), sipas afateve të kryerjes së pagesave të përcaktuara nga çdo njësi e qeverisjes vendore. (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë vërtetim për taksat dhe tarifat vendore).

Ky kriter do të përmbushet nga OE me anë të Formularit Përmbledhës së Vetëdeklarimit. Dokumentacioni provues, i cili vërteton pagimin e taksave dhe tarifave vendore, do të dorëzohet nga ofertuesi i kualifikuar i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.

Kriteri i mësipërm është vendosur bazuar në nenin 76, pika 2 të LPP si dhe në ligjin Nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar.

2.3 Kapaciteti teknik dhe profesional:

2.3.1. Për të provuar përvojën e mëparshme operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizime të ngjashme në një vlerë jo më të vogël se 40% e vlerës së perlloritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Kjo do të vërtetohet me dokumentat e mëposhtme:

- a) **Ne rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin publik,** operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të leshuara nga një ent publik ose fatura tatimore të shitjes, ku të jenë shënuar saktë datat, shumat, sasi të mallrave të furnizuara,

ose

- b) **Në rast se përvoja e mëparshme është realizuar me sektorin privat,** si dëshmi do të pranohen vetëm fatura tatimore shitje, të plotsuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të jenë shënuar saktë datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Kriteri 2.3.1 është vendosur referuar nenit 40 pika 4 të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” si dhe bazuar në nenin 77 pika 4 të LPP nr.162, datë 23.12.2020 “Per Prokurimin Publik”.

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të disponojë dhe të paraqesë certifikatën e vlefshme:

- **SSH/EN-ISO 9001-2015 “Sistemi i Menaxhimit të Cilësisë” ose ekuivalente, e vlefshme dhe të perputhet me mallin objekt prokurimi.**

Certifikata e mesipërme duhet të jetë e leshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Kriteri 2.3.2 është vendosur në perputhje me Nenin 40 pika 6 germa c të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, bazuar në nenin 44 pika 1 të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 si dhe bazuar në nenin 79 të LPP.

Ky kriter është vendosur që AK të ketë siguri që operatori ekonomik që do të ofertojë të jetë i pajisur me certifikatën e menaxhimit të cilësisë gjë e cila krijon bindjen dhe siguri të AK që ky OE do të ofertojë produkte të certifikuar të një cilësie të mirë e në perputhje me standartet ndërkombëtare të cilësisë.

2.3.3 Operatori ekonomik duhet te disponojë **2 (dy) automjete të përshtatshme për transport me kapacitet mbajtes minimalisht 1.5 ton**, për transportin e mallit objekt prokurimi, për të cilin duhet të paraqesë dokumentat e mëposhtem:

- **Aktin e pronësisë së mjetit përkatës;**
- **Kontratën noteriale të marrjes me qira të mjetit,** shoqëruar me dokumentacionin përkatës të pronësisë së mjetit që ka pronari, i cili e jep me qira.

Për mjetet që shënohen në regjistra publikë (qoftë në pronësi apo dhe me qira) duhet të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), certifikata e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit, taksat vjetore si dhe lejen e transportit për vete ose të tjerë për ato mjete që pajisen me leje transporti sipas legjislacionit në fuqi.

Ky kriter do të përmbushet nga OE me anë të Formularit Përmbledhës së Vetëdeklarimit. Dokumentacioni provues, i cili vërteton disponimin e automjeteve, do të dorëzohet nga ofertuesi i kualifikuar i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.

Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5/ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit. Nisur nga sasitë e mallit që janë të konsiderueshme në numër si dhe pesha e tyre është parë e nevojshme të kërkojnë dy automjete të përshtatshme me tonazh minimalisht 1.5 ton.

2.3.4 Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar mesatarisht **4 (katër)** punonjës për muajin e fundit, të vërtetuar me ;

- a) Vërtetimi të lëshuar nga autoritetet përkatëse, në mënyrë elektronike, ku të specifikohet numri i punonjësve për muajin e fundit;
- b) Listëpagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën e kërkuar shoqëruar me formularët e deklarimit të pagesave për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore.

Ky kriter do të përmbushet nga OE me anë të Formularit Përmbledhës së Vetëdeklarimit. Dokumentacioni provues, i cili vërteton për disponueshmërinë e stafit,

do të dorëzohet nga operatori ekonomik i renditur i pariperpara publikimit te njoftimit te fituesit dhe nisjes se afateve te ankimit.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5/b/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Percaktimi mesatarisht i 4 punonjesve eshte bere duke marre parasysh natyren e objektit te prokurimit dhe fakti qe kemi kerkuar dy automjete dhe nisur nga kjo, pjese te stafit duhet te kete shofer (dy) respektivisht per dy automjetet si dhe 2 punetore qe do te merren me ngarkim-shkarkimin e mallit, respektivisht 1 punetor per secilin mjet.

2.3.5 Ne rast se operatori ekonomik ofertues nuk eshte prodhues, ai duhet te paraqese autorizim nga prodhuesi ose distributori per mallin objekt prokurimi. Ne rastin e autorizimit me distributorin te dokumentohet lidhja e tij me prodhuesin.

Kriteri 2.3.5 është vendosur ne perputhje me Nenin 40 pika 6 germa b) te VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

2.3.6 Operatori ekonomik për mallrat e furnizuara objekt prokurimi duhet të paraqesë një deklaratë për garancinë e mallit e cila të jete 1 vit nga marja e tyre në dorëzim.

Argumentimi:Kriteri **2.3.6** eshte vendosur ne perputhje me Nenin 40 te VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe bazuar ne nenin 79 te LPP. Ky kriter eshte vendosur qe AK te kete sigurine qe operatori ekonomik do te ofertoje produkte te certifikuara te nje cilesie te mire e ne perputhje me standartet nderkombetare te cilesise si dhe te marre persiper zevendesimin e tyre gjate periudhes se garancise.

2.3.7 Operatori ekonomik për artikujt e kërkuar duhet të paraqesë çertifikatat e produktit si më poshtë:

• **Tavolinë nxënësi cikli i ulët SSH/ EN 1729-1:2015 (EN 1729-1: 2015/ AC:2016 SSH EN 1729-2:2012 + A1:2015 e vlefshme ose ekuivalente .**

• **Karrige nxënësi cikli i ulët : SSH /EN 1729-1:2015 (EN 1729-1: 2015/ AC:2016 SSH EN 1729-2:2012 + A1:2015 ,e vlefshme ose ekuivalente .**

• **Karrige mësuesi: SSH/ EN 1335-1:2021, SSH EN 1335-2:2018 e vlefshme ose ekuivalente.**

• **Tavoline pune : SSH/ EN 527-1:2011, SSH EN 527-2:2016+A1:2019, e vlefshme ose ekuivalente.**

• **Dollap për klasa (Raft) : SSH/ EN 14073-3:2004 , SSH EN 14074:2004, e vlefshme ose ekuivalente.**

• **Karrige rrotulluese (zyre): SSH/ EN 1335-1:2021, SSH EN 1335-2:2018 ,e vlefshme ose ekuivalente.**

Çertifikatat e mesiperme duhet te jene te leshuara nga nje organ i vleresimit te konformitetit, i akredituar nga organizmi kombetar i akreditimit ose organizma nderkombetare akreditues, te njohur nga Republika e Shqiperise.

Ne rastet kur oferta dorezohet nga nje BOE, operatorët duhet te disponojne certifikatat e kerkuara në përputhje me raportin e pjesëmarrjes në furnizim, të përcaktuara në akt marrëveshje.

Kriteri 2.3.7 eshte vendosur ne perputhje me Nenin 40 pika 6 germa c te VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, bazuar ne nenin 44 pika 1 te VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 si dhe bazuar ne nenin 79 te LPP.

Ky kriter eshte vendosur qe AK te kete sigurine qe operatori ekonomik qe do te ofertoje te jete i pajisur me certifikatat e produktit gje e cila krijon bindjen dhe sigurine te AK qe ky OE do te ofertoje produkte te certifikuara te nje cilesie te mire e ne perputhje me standartet nderkombetare te cilesise.

2.3.8. Operatoret Ekonomik pjesmarres ne kete procedure prokurimi, duhet te paraqesin mostrat per elementet e meposhtem sipas preventivit dhe specifikimeve te kerkuara ne daten dhe oren e hapjes se tenderit ne ambjentet e Drejtorise se Prokurimeve Publike (date 16 /10 / 2023 ora 10 : 00), konkretisht:

Nr.	Emertimi	Njesia	Sasia
1	Tavolina nxenesi dyvendeshe -Arsimi I Mesem (120 x 45 x 70 cm)	cope	1
2	Karrike nxenesi Arsimi i Mesem (35 x 38 x 42-45/75 cm)	cope	1
3	Tavolina nxenesi cikli ulet (120 x 64 x 45 cm)	cope	1
4	Karrike nxenesi cikli ulet (35 x 38 x 37/70 cm)	cope	1

Mosparaqitja e mostrave përbën kusht për skualifikim.

Argumentimi: Kriteri **2.3.8** bazohet ne Nenin 40 pika 6,germa a) te VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” dhe eshte vendosur duke pasur parasysh numrin e konsiderueshem dhe natyren specifike te ketij produkti, per ti deshmuar autoritetit kontraktor se malli i ofruar ploteson kerkesat e pecaktuara ne dokumentat e tenderit.

Argumentimi i specifikimeve teknike

Argumentim: Në bazë të nenit të 36, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 15, pika 3/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Specifikimet teknike jane hartuar nga Ministria e Arsimit dhe Sporteve për objektin që prokurohet. Specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara si dhe janë në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.